

STATUT I SHOQËRISË
AICA IMOBILIARE SH.A.

Data 17.10.2022


A handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping, fluid strokes, located at the bottom center of the page.

TABELA E LËNDËS

KREU I. TË PËRGJITHSHME	3
NENI 1.01 PËRKUFIZIMET	3
NENI 1.02 EMËRTIMI, THEMELUESIT, SELIA.....	3
NENI 1.03 OBJEKTI.....	3
KREU II. KAPITALI I REGJISTRUAR	4
NENI 2.01 KAPITALI I REGJISTRUAR DHE KONTRIBUTET NË KAPITAL	4
NENI 2.02 LLOJET E AKSIONEVE	4
NENI 2.03 REGJISTRI I AKSIONEVE	5
NENI 2.04 KALIMI I AKSIONEVE.....	5
NENI 2.05 E DREJTA E PARABLERJES	5
NENI 2.06 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT	6
KREU III. ORGANET E SHOQËRISË.....	6
NENI 3.01 ORGANET E SHOQËRISË	6
NENI 3.02 KOMPETENCAT E ASAMBLESE DHE VENDIMMARRJA	7
NENI 3.03 THIRRJA E ASAMBLESE.....	7
NENI 3.04 MBLEDHJET E ASAMBLESE.....	7
NENI 3.05 VOTIMI ME PROKURË	8
NENI 3.06 EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR	8
KREU IV. ADMINISTRATORËT	8
NENI 4.01 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE.....	8
NENI 4.02 EMËRIMI I ADMINISTRATORËVE.....	8
KREU V. KËSHILLI MBIKËQYRËS	9
NENI 5.01 KOMPETENCAT E KËSHILLIT MBIKËQYRËS DHE TË KOMITETEVE TË TIJ	9
NENI 5.02 EMËRIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT	9
NENI 5.03 MBLEDHJET E KËSHILLIT	10
KREU VI. DIVIDENDËT DHE FITIMET	10
NENI 6.01 DIVIDENDËT	10
NENI 6.02 FITIMET	10
KREU VII. PRISHJA.....	10
NENI 7.01 PRISHJA DHE LIKUIDIMI.....	10



KREU I. TË PËRGJITHSHME

Neni 1.01 Përkufizimet

Fjalët e përdorura në këtë Statut me germa kapitale do të kenë kuptimin si më poshtë:

“**Aksionari Preferencial**” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 2.05(a) (*E Drejta e Parablerjes*) i këtij Statuti.

“**Aksionari Transferues**” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 2.05(a) (*E Drejta e Parablerjes*) i këtij Statuti.

“**Asambleja**” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 3.01(a) (*Organet e Shoqërisë*) i këtij Statuti.

“**Data e Nënshkrimit**” është data në të cilën është nënshkruar ky Statut.

“**Këshilli**” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 3.01(b) (*Organet e Shoqërisë*) i këtij Statuti.

“**Ligji**” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar.

“**Shoqëria**” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 1.02(a) (*Emërtimi, Themeluesit, Selia*) i këtij Statuti.

“**Statuti**” është statuti i Shoqërisë.

Neni 1.02 Emërtimi, Themeluesit, Selia

(a) Emri i shoqërisë është AICA IMOBILIARE Sh.A. (“**Shoqëria**”).

(b) Aksionar i Shoqërisë është Z. Armand Hoxha, i ditëlindjes 24.03.1974, lindur në Radë, Durrës, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H40324011R.

(c) Selia e Shoqërisë është në adresën: Tiranë, Vorë Muçaj ZK.2726, nr. pasurie 142/46, vol.9, fq.157.

Neni 1.03 Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme, por pa u kufizuar në to: *Ndërtim, zhvillim, shfrytëzim hotelesh dhe zonë turistike dhe çdo lloj veprimtarie të ligjshme që konsiderohet fitimprurëse për shoqërinë.*



KREU II. KAPITALI I REGJISTRUAR

Neni 2.01 Kapitali i Regjistruar dhe Kontributet në Kapital

(a) Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 4,722,900 lekë (katër milion e shtatëqind e njëzet e dy mijë e nëntëqind lekë) dhe është i ndarë në 42,731 (dyzet e dymijë e shtatëqind e tridhjetë e një) aksione të zakonshme si dhe 2,249 (dymijë e dyqind e dyzet e nëntë) aksione me përparësi, me vlerë nominale 105 (njëqind e pesë) lekë secili.

(b) Kontributi i aksionarëve në kapitalin e Shoqërisë është si më poshtë:

Aksionari:	Armand Hoxha
Lloji i kontributit:	Para
Numri i aksioneve të zakonshme:	42,731 (dyzet e dymijë e shtatëqind e tridhjetë e një)
Numri i aksioneve me përparësi:	2,249 (dymijë e dyqind e dyzet e nëntë)
Vlera e aksioneve:	105 lekë/aksion

(c) Aksionet nënshkruhen me kontribut në para ose në natyrë. Të paktën $\frac{1}{4}$ (një e katërta) e vlerës së kontributit në para duhet të shlyhet përpara regjistrimit të Shoqërisë. Kontributi në natyrë duhet të shlyhet tërësisht përpara regjistrimit të Shoqërisë.

(d) Administratorët mund t'u kërkojnë aksionarëve pagimin e kontributeve të pashlyera në lidhje me aksionet e tyre dhe çdo aksionar (pas marrjes së njoftimit prej 14 ditësh në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për aksionet e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me kështu të kontributeve të papaguara.

(e) Zotëruesit e përbashkët të një aksioni do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

Neni 2.02 Llojet e Aksioneve

(a) Aksionet do të jenë të zakonshme dhe me përparësi me të drejtë vote.

(b) Aksionet me përparësi gëzojnë cilësitë e mëposhtme:

- të drejta vote në masën 5% (pesë për qind) në Asamblenë e Përgjithshme, që ndahet proporcionalisht mes aksioneve me përparësi;
- të drejtën e dividendit në masën 50% (pesëdhjetë për qind) të fitimit të Shoqërisë, të ndarë proporcionalisht mes aksioneve me përparësi;
- të drejtën për të tërhequr dividend pavarësisht nëse e drejta për të tërhequr dividend ushtrohet ose jo për aksionet e zakonshme;

(c) Në lidhje me aksionet e zakonshme përqindja e së drejtës së dividendit (në masën 50%) dhe të votës (95%) për do të ndahet proporcionalisht mes tyre përkatësisht nga përqindja që mbetet pas përqindjes në të drejtën e dividendit dhe të drejtës së votës së ruajtur për aksionet me përparësi, parashikuar te paragrafi (ii) dhe (i) më lart.

(d) Në rast të emetimit të aksioneve të reja nga Shoqëria, kjo e fundit detyrohet të emetojë proporcionalisht dhe aksione me përparësi (në mënyrë që Aksionari Preferencial të ruajë të drejtat e tij në masën e përcaktuar në këtë Statut për të drejtën e votës dhe dividendit), me të drejtat e parashikuara te paragrafi (b) më lart dhe t'ia ofrojë këto aksione për nënshkrim Aksionarit Preferencial. Ky i fundit nuk mund të detyrohet në asnjë rast që t'ia paguajë Shoqërisë kontribut të ri për kalimin në zotërim të aksioneve të reja me përparësi.

(e) Në rast të zmadhimit të kapitalit me kontribute nga aksionarët, Aksionarit Preferencial nuk mund t'i kërkohej të paguajë kontribut të ri, pavarësisht se Aksionari Preferencial mund të japë miratim për një vendim të tillë.

Neni 2.03 Regjistri i Aksioneve

Administratori është përgjegjës për krijimin dhe funksionimin e regjistrit të aksioneve, i cili përmban: emrin dhe mbiemrin e aksionarit, apo emrin e regjistruar, nëse është person juridik, vlerën nominale të aksionit, adresën e banimit apo zyrën qendrore të aksionarit dhe datën e kryerjes së regjistrimit, në përputhje me Nenin 119 të Ligjit.

Neni 2.04 Kalimi i Aksioneve

(a) Aksionet mund të transferohen lirisht te aksionarët e tjerë të Shoqërisë, ndërsa transferimi te të tretët mund të bëhet vetëm me vendimin e Asamblesë.

(b) Në çdo rast, aksionari që dëshiron të kalojë aksionin/aksionet që zotëron, njofton Administratorin me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për këtë kalim. Njoftimi përmban numrin e aksioneve që do të kalohen, si dhe të dhënat identifikuese të personit të cilit do t'i kalohen aksionet.

(c) Për transferimin e aksioneve te të tretët zbatohet e drejta e parablerjes, sipas rregullimeve të përcaktuara në Neni 2.05 (*E Drejta e Parablerjes*) të këtij Statuti.

(d) Në rastet e kalimit të aksionit/aksioneve nëpërmjet trashëgimisë, Asambleja vendos nëse do të pranojë si aksionar të personit të cilit i ka kaluar aksioni. Nëse Asambleja nuk arrin shumicën e kërkuar për pranimin e aksionarit trashëgimtar, Shoqëria do të kryejë procedurat për anulimin e aksioneve të trashëguara në përputhje me Nenin 186.2.(a) të Ligjit.

Neni 2.05 E Drejta e Parablerjes

(a) Aksionari që dëshiron të shesë aksionin/aksionet që zotëron ("**Aksionari Transferues**"), duhet t'ia ofrojë fillimisht aksionarit që zotëron aksionet me përparësi ("**Aksionari Preferencial**").



(b) Aksionari Transferues njofton Aksionarin Preferencial për numrin e aksioneve që do të shesë dhe çmimin e shitjes, me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike. Aksionari Preferencial përgjigjet brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit, për pranimin e propozimit ose refuzimin e tij.

(c) Nëse Aksionari Preferencial nuk përgjigjet brenda afatit të përcaktuar në pikën e mësipërme të këtij Neni, propozimi konsiderohet i refuzuar.

(d) Nëse propozimi i paraqitur nga Aksionari Transferues refuzohet nga Aksionari Preferencial, Aksionari Transferues ua ofron aksionarëve të tjerë të Shoqërisë blerjen e aksionit, me çmimin e ofruar fillimisht Aksionarit Preferencial.

(e) Aksionari/aksionarët përgjigjen brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit, për pranimin e propozimit ose refuzimin e tij.

(f) Nëse njoftimi për refuzim jepet para përfundimit të afatit të përcaktuar në paragrafin e mësipërm të këtij Neni, ky afat konsiderohet i përfunduar.

(g) Nëse aksionari/aksionarët të cilëve u drejtohet propozimi, nuk përgjigjen brenda afatit të përcaktuar në pikën (e) të këtij Neni, propozimi konsiderohet i refuzuar.

(h) Në rast se oferta pranohet nga më shumë se një aksionar, Aksionari Transferues detyrohet t'ia shesë aksionin, aksionarit, njoftimi i të cilit i ka mbërritur më parë në kohë Aksionarit Transferues.

(i) Nëse propozimi nuk pranohet nga asnjë prej aksionarëve, Aksionari Transferues mund t'ia transerojë aksionin palëve të treta, me çmimin e ofruar fillimisht ndaj Aksionarit Preferencial.

(j) Aksionari Transferues njofton Administratorin e Shoqërisë për shitjen e aksionit/aksioneve.

Neni 2.06 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

(a) Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë në bazë të Neneve 168-172 të Ligjit, me anë të emetimit të aksioneve të reja, zmadhimin të kufizuar të kapitalit, zmadhimin të autorizuar të kapitalit ose zmadhimin të kapitalit me aktive të Shoqërisë në bazë të kushteve të përcaktuara në Pjesën V, Titullin V, Kreret II, III, IV dhe V të Ligjit.

(b) Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve, zvogëlimit të thjeshtëzuar të kapitalit, apo anulimit të aksioneve në bazë të Neneve 181-186 të Ligjit me kusht që kapitali nuk mund të jetë më i vogël se kapitali i regjistruar i Shoqërisë.

KREU III. ORGANET E SHOQËRISË

Neni 3.01 Organet e Shoqërisë



Organet e Shoqërisë janë:

- (a) Asambleja e Përgjithshme (“**Asambleja**”);
- (b) Këshilli Mbikëqyrës (“**Këshilli**”);
- (c) Administratori/Administratorët.

Neni 3.02 Kompetencat e Asamblesë dhe Vendimmarrja

Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme, pavarësisht natyrës së çështjes së shtruar, mund të merret së paku me aksionet që zotërojnë 96% (nëntëdhjetë e gjashtë për qind) të të drejtave të votës së Shoqëri.

Neni 3.03 Thirrja e Asamblesë

(a) Asambleja mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit fiskal. Asambleja thirret nga Administratorët, nga anëtarët e Këshillit në rastet e parashikuara në Nenin 136 të Ligjit, apo nga aksionarët që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit të regjistruar, sipas Nenit 139 të Ligjit.

(b) Mbledhja e Asamblesë thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (e-mail) drejtuar çdo aksionari, përfshirë edhe përfaqësuesin e aksioneve në zotërim të përbashkët.

(c) Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme së njoftimit apo mosmarrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

Neni 3.04 Mbledhjet e Asamblesë

(a) Asambleja merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e një kuorumi ku janë të pranishëm aksionarët që zotërojnë kuotat me të paktën 96% (nëntëdhjetë e gjashtë për qind) të të drejtave të votës në Shoqëri. Aksionarët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call), audio ose audio-video.

(b) Asambleja cakton Kryetarin e mbledhjes, si dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

(c) Asambleja vendos me votim të hapur, me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:

- (i) Kryetari; ose
- (ii) aksionarët që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.



(d) Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i aksionarit ka të njëjtin vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë aksionari.

Neni 3.05 Votimi me Prokurë

(a) Një aksionar mund të përfaqësohet në Asamble në bazë të një prokure, nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë, e cila mund të përfshijë mbledhjet vijuese, por vetëm për të njëjtin rend dite.

(b) Autorizimi me shkrim ose një kopje e noterizuar depozitohet në selinë e Shoqërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë.

Neni 3.06 Ekspertët Kontabël të Autorizuar

(a) Asambleja cakton një ose më shumë persona fizikë ose një shoqëri ekspertësh kontabël të autorizuar si ekspertë kontabël të autorizuar të shoqërisë për 3 (tre) vjet me radhë, në pajtim me shkronjën "ç", pika 2 e nenit 135 të Ligjit.

(b) Ekspertët kontabël të autorizuar i raportojnë Këshillit për çështjet kryesore që rezultojnë nga kontrolli financiar dhe në veçanti, për dobësi të kontrollit të brendshëm në lidhje me procesin e raportimit financiar.

(c) Personat e mëposhtëm emërohen si ekspertë kontabël të autorizuar deri në emërimin nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme sipas shkronjës "ç", pika 2 e nenit 135 të Ligjit: Z. Ilir Daiu, person fizik, me NUIS L91310004V, regjistruar në QKB më 10/01/2019, me seli në Tiranë, Bulevardi Gjergj Fishta, Rruga Nikolla Jorgo, Kulla 8, Hyrja 1, Ap 10.

KREU IV. ADMINISTRATORËT

Neni 4.01 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët përfaqësojnë Shoqërinë në lidhje me të tretët, marrin vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare, si dhe ushtrojnë çdo kompetencë tjetër të parashikuar në Ligj.

Neni 4.02 Emërimi i Administratorëve

(a) Asambleja zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të Shoqërisë.

(b) Administratori emërohet për një periudhë kohore prej 3 (tre) vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.

(c) Asambleja mund të shkarkojë në çdo kohë Administratorët nga detyra, pa cenuar të drejtat që burojnë nga një kontratë shërbimi e lidhur me Shoqërinë.

(d) Administrator i Shoqërisë është Z. Armand Hoxha, i datëlindjes 24.03.1974, lindur në Radë, Durrës, Shqipëri mbajtës/e i/e letërnjoftimit me numër personal H40324011R.



KREU V. KËSHILLI MBIKËQYRËS

Neni 5.01 Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës dhe të Komiteteve të tij

(a) Këshilli ushtron këto kompetenca:

- (i) Vëzhgon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratorët;
- (ii) Kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së Shoqërisë me kërkesat e Ligjit dhe të Statutit;
- (iii) Shqyrton dhe kontrollon librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e Shoqërisë;
- (iv) Miraton dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit dhe publikimit;
- (v) Ushtron çdo kompetencë tjetër të parashikuar në Ligj.

(b) Këshilli mund të krijojë komitete të posaçme të përbëra nga anëtarët e vet, në përmbushje të detyrave të tij, për të përgatitur mbledhjet apo vendimet, ose për të mbikëqyrur vënien në zbatim të vendimeve të Këshillit, sidomos ato të lidhura me veprimtarinë e administratorëve, shpërblimin e tyre dhe auditimin e librave e të regjistrimeve kontabël. Secili komitet duhet të përbëhet në shumicën e vet nga anëtarë të pavarur, që nuk janë administratorë. Mbledhjet e komiteteve të posaçme regjistrohen në procesverbal.

Neni 5.02 Emërimi i Anëtarëve të Këshillit

(a) Asambleja emëron 3 (tre) deri në 21 (njëzet e një) persona fizikë në cilësinë e anëtarëve të Këshillit në përputhje me Nenin 155(2) të Ligjit. Anëtarët e Këshillit zgjedhin mes tyre, Kryetarin dhe Nënkryetarin e Këshillit.

(b) Vendimi i Asamblesë për emërimin e anëtarëve të Këshillit merret me shumicë të zakonshme.

(c) Anëtarët e Këshillit emërohen për një periudhë kohore prej 3 (tre) vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.

(d) Anëtarët e Këshillit mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë. Vendimi mbi shkarkimin merret me shumicë të zakonshme.

(e) Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të Këshillit:

- (i) Z. Ralf Kazazi, i datëlindjes 16.12.1994, lindur në Tiranë, Shqipëri mbajtës i letërnjoftimit me numër personal J41216046Q;
- (ii) Z. Fatmir Kazazi, i datëlindjes 21.09.1958, lindur në Tiranë, Shqipëri, mbajtës/e i/e letërnjoftimit me numër personal F80921046O;



- (iii) Znj. Ilda Çela, e ditëlindjes 03.04.1995, lindur në Kavajë, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal J55403053S.

Neni 5.03 Mbledhjet e Këshillit

- (a) Mbledhjet e Këshillit do të mbahen të paktën dy herë në vit dhe sa herë të jetë e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë.
- (b) Thirrja e mbledhjes kryhet nga Kryetari 10 (dhjetë) ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi dërgohet me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike (e-mail) dhe duhet të përmbajë rendin e ditës dhe çdo informacion të cilësuar si të nevojshëm nga Kryetari.
- (c) Vendimet e Këshillit merren kur në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve, me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Nëse numri i votave është i barabartë, atëherë vota e Kryetarit mbizotëron.
- (d) Anëtarët e Këshillit mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, përfshirë komunikimin video dhe audio-konferencë.
- (e) Zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit regjistrohet në një procesverbal, i cili mbahet nga një sekretar i caktuar nga Kryetari. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar i Këshillit ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.

KREU VI. DIVIDENDËT DHE FITIMET

Neni 6.01 Dividendët

- (a) Në përputhje me dispozitat e Ligjit, Shoqëria me shumicë të zakonshme të votave të Asamblesë mund të deklarojë dividendët, në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.
- (b) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar që përfaqësojnë aksionet për të cilët paguhet dividendi.

Neni 6.02 Fitimet

- (a) Asambleja, me shumicë të cilësuar në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe me këtë Statut, mund të vendosë në lidhje me fitimet që rezultojnë nga bilanci, pas zbritjes së rezervës ligjore dhe të gjithë shumave që Asambleja vendos si rezervë.
- (b) Asambleja mund të vendosë për krijimin e rezervave të tjera nga fitimet vjetore.

KREU VII. PRISHJA

Neni 7.01 Prishja dhe Likuidimi



Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.

Aksionari i vetëm nënshkruan këtë Statut më poshtë në datën 17.10.2022.

Armand Hoxha

